



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 8 Prill 2021

Nr: 212

VENDIM

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 148, DATË 16.03.2021, TË  
KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE, “PËR CAKTIMIN E VENDEVE  
TË NUMËRIMIT TË VOTAVE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË,  
TË DATËS 25 PRILL 2021”**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenet 19, paragrafët 1, shkronja “n” dhe 2, nenin 93, paragrafi 1, dhe nenin 94, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

V Ë R E N

Vendet e Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021, janë përcaktuar me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 148, datë 16 Mars 2021, “Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”, sipas lidhjes 1 të tij.

Vendndodhja e VNV së ZAZ nr. 10 u miratua “Menca e konviktit Kosova”, Bashkia Has;

Vendndodhja e VNV së ZAZ nr. 23 u miratua Palestra e Shkollës “Leonik Tomeo”, Bashkia Durrës;

Vendndodhja e VNV së ZAZ nr. 24 u miratua Palestra e Shkollës “Hysen Çela”, Bashkia Durrës;

Prefekti i qarkut Durrës me shkresën nr. 3452 prot., datë 08.04.2021 referon se palestra e shkollës “Hysen Çela” ka një ambjent të mbyllur/izoluar dhe shumë të vështirë për t’u ajrosur, ç’ka përbën problem për situatën covid dhe përhapjen e virusit. Për këtë shkak, për caktimin e VNV-së së ZAZ-së nr. 23 referon palestrën e shkollës “Jan Kukuzeli”, dhe për VNV-në e ZAZ-së nr. 24, palestrën e shkollës “Leonik Tomeo”.



Data: 8 Prill 2021

Nr. 212

Për disa ndryshime në vendimin nr. 148, datë 16.03.2021 “Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021”

Prefekti i qarkut Kukës me shkresën nr. 3453 prot., datë 08.04.2021 referon se ambjenti i VNV-së të ZAZ nr. 10, miratuar te menca e konviktit Kosova, ka pësuar dëmtime dhe nuk ka mundësi për riparim. Për këtë shkak, për caktimin e VNV-së së ZAZ-së nr. 10 referon palestrën e shkollës “Skenderbeu”. Këto objekte, sikundër mjedisi përkatës për caktimin e VNV-ve, plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, si dhe plotësojnë kriteret teknike të përcaktuara në Vendimin e Komisionit Rregullator nr. 3, datë 9.02.2021 “Për kriteret e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave”.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n” dhe 2, nenin 93, paragrafi 1, dhe nenin 94, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

### **VENDOSA:**

1. Në lidhjen 1, bashkelidhur vendimit nr. 148, datë 16 Mars 2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”, bëhen ndryshimet si më poshtë:
  - a) Në Qarkun Durrës, në KZAZ-në nr.23, objekti i propozuar për VNV, palestra e shkollës “Leonik Tomeo” zëvendësohet me palestra e Shkollës “Jan Kukuzeli”.
  - b) Në Qarkun Durrës, në KZAZ-në nr.24, objekti i propozuar për VNV, “palestra e shkollës “Hysen Çela” zëvendësohet me palestra e Shkollës “Leonik Tomeo”.
  - c) Në Qarkun Kukës, në KZAZ-në nr.10, objekti i propozuar për VNV, “Mensa e konviktit Kosova” zëvendësohet me palestra e Shkollës “Skenderbeu”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**

